

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË E BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2023

1. KUADRILIGJOR KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë mbështetet në nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në Ligjin nr. 8269/1997 për Bankën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjin nr. 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 133/2013 "Për sistemin e pagesave"; Ligjin 55/2020 për shërbimet e pagesave; Ligjin nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; Ligjin nr. 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë", si dhe në statutin e Bankës së Shqipërisë miratuar me vendim nr. 90/2015 nga Këshilli Mbikëqyrës.

2. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VEPRIMTARINË E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka përbushur rekomandimet e lëna nga Kuvendi dhe ka raportuar rregullisht gjatë vitit për ecurinë e zbatimit të tyre.

3. AMBIENTI EKONOMIK E FINANCIAR NË TË CILIN KA VEPRUAR BANKA E SHQIPËRISË

Viti 2023 u karakterizua nga një pikë kthese në inflacionin global i ndikuar nga stabilizimi i çmimeve të lëndëve të para si dhe nga shtrëngimi i sinkronizuar i politikës monetare, i cili dha impakt negativ mbi aktivitetin ekonomik botëror. Megjithatë, ekonomia shqiptare përjetoj një vit pozitiv. Vëllimi i aktivitetit ekonomik erdhi në rritje, inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi rënie të ndjeshme, tregu i punës, treguesit e shëndetit ekonomik e financiar të vendit, pozicioni fiskal dhe ai i jashtëm u përmirësuan. Treguesit kryesorë të stabilitetit financiar mbetën solide. Kjo ecuri pasqyroj bazat e gjera të rritjes së ekonomisë shqiptare, fleksibilitetin e sektorit privat, si dhe reagimin e duhur të politikave monetare e fiskale.

Qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste, tregu i punës i mbingopur dhe rritja ekonomike e shpejtë diktuan vijimin kursit normalizues të politikës monetare. Banka e Shqipërisë vlerëson se ky kurs i politikës monetare është i nevojshëm për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv në afatin e mesëm. Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka ushtruar mbikëqyrje të kujdesshme në drejtim të parandalimit të akumulimit të rreziqeve për sistemin bankar. Ky i fundit është fitimprurës, i mirëkapitalizuar dhe me parametra të shëndoshë për të mbështetur ekonominë me financim.

Zhvillimet ekonomike

Aktiviteti ekonomik në vend u rrit me 3.3% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023, pas rritjes me 4.9% në vitin 2022. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga zgjerimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve, me specifikisht nga të ardhurat e larta nga turizmi, si dhe në atë të ndërtimit. Në anën tjetër, sektori i industrisë ka shfaqur rënie dhe i bujqësisë nuk është rritur. Konsumi privat vijoi të zgjerohej, në reflektim të të ardhurave të disponueshme më të larta, dhe dha mbështetjen kryesore në rritjen ekonomike. Investimet, kryesisht ato private, vijuan të zgjerohen me ritëm të shpejtë e të japin kontribut pozitiv gjatë vitit 2023. Kërkesa e lartë për shërbime turistike shqiptare diktoj një zgjerim të fortë të eksportit të shërbimeve dhe një ndikim pozitiv në rritje nga eksportet neto. Politika fiskale ishte konsoliduese, e karakterizuar nga rritja e shpejtë e të ardhurave buxhetore. Deficiti buxhetor u vlerësua në rreth 1.4% të PBB-së në vitin 2023, nga 3.7% një vit më parë.

Për herë të parë në tre dekadat e fundit, llogaria korrente regjistroi një suficit gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023, të vlerësuar në nivelin 0.2% të PBB-së. Në të njëjtën kohë, raporti i borxhit të huaj ndaj PBB-së u reduktua dhe treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë kanë vazhduar të përmirësohen.

Kërkesa dhe prodhimi më i lartë mbështetën rritjen e punësimit dhe të pagave. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit, ndërsa norma e papunësisë shënoi nivelin 10.5% në tremujorin e tretë. Rritja e kërkesës për fuqi punëtore u përthye në rritje të shpejtë të pagave, ku në sektorin privat ato u rritën me 13.0%. Ecuria pozitive e punësimit dhe e pagave siguruan mbështetje për të ardhurat e familjeve, por ato krijuan gjithashtu premisa që presionet inflacioniste të jenë më të qëndrueshme.

Inflacioni mesatar i vitit 2023 u zvogëlua në nivelin 4.8% nga 6.7% një vit më parë. Rënia e inflacionit u diktua nga dobësimi i inflacionit në tregjet e huaja, nga mbiçmimi i kursit të këmbimit dhe nga reduktimi gradual i presioneve të brendshme inflacioniste. Megjithatë, ritmi i rënies së inflacionit erdhi në ngadalësim gjatë vitit, duke pasqyruar nivelet ende të larta të presioneve të brendshme mbi kostot e punës dhe çmimet e konsumit. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë rriti dy herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2023, duke e çuar atë nga 2.75% në 3.25%. Ky ritëm normalizimi ishte më i ngadaltë se ai i vitit paraardhës, si pasojë e kahut konsolidues të politikës fiskale dhe e forcimit të kursit të këmbimit.

Tregjet financiare u shfaqën relativisht të qeta gjatë vitit 2023. Normat e interesit në tregun financiar janë më të larta se përpara nisjes së kursit normalizues të politikës monetare. Megjithatë, ato mbeten ende stimuluese për financimin e konsumit dhe të investimeve. Kombinuar me përjasjen pozitive të bankave ndaj kreditimit, ato nxitën një rritje të shpejtë të kredisë gjatë vitit. Kredia për sektorin privat u rrit me 9.9% gjatë vitit 2023, ritëm i ngjashëm me atë të shënuar në dy vitet e fundit. Cilësia e portofolit të kredisë u përmirësua më tej dhe treguesi i kredive me probleme ra në nivelin 4.7% në muajin dhjetor, norma më e ulët e dekadës së fundit. Kursi i këmbimit të lekut ndaj euros u forcua ndjeshëm, si pasojë e përmirësimit të shpejtë të bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë dhe rritjes së ofertës së euros në tregun e brendshëm valutor.

Ecuria e sektorit bankar

Sektori bankar shqiptar e mbylli vitin 2023 me një rezultat financiar pozitiv, me një nivel të lartë të treguesve të likuiditetit e të kapitalizimit të veprimtarisë, të pasqyruar në një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18%, dhe me tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë. Ai shfaqet rezistent ndaj goditjeve dhe me rreziqe të kontrolluara. Zgjerimi i aktiveve të sektorit bankar me rreth 5% mori formën e rritjes së kredisë dhe me investimet në letra me vlerë. Rritja e detyrimeve të bankave lidhet pothuajse tërësisht me zgjerimin e depozitave me rreth 11.5% në terma vjetorë.

Rreziqet e veprimtarisë bankare paraqiten të kontrolluara gjatë vitit 2023. Treguesit që lidhen me rritjen e kredisë, pozicionin e likuiditetit, luhatjet në tregun valutor, përqendrimin e ekspozimeve dhe të aktivitetit të sistemit financiar flasin për rreziqe të kontrolluara. Ndërkohë, rreziqet që lidhen me treguesit e kredisë në valutë, të hendekut negativ të likuiditetit midis aktiveve dhe detyrimeve për maturitetet afatshkurtra dhe të kredisë për blerje pasurish të paluajtshme janë ulur.

Konfigurimi i sistemit bankar në vend nuk ka ndryshuar gjatë vitit.

Në kontekstin strukturor, sektori financiar shqiptar shënoi tre arritje të rëndësishme: (i) daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si lista grië e vendeve sa i takon zhvillimit të infrastrukturës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën ndaj terrorizmit; (ii) aplikimin e Autoritetin Bankar Evropian për njohjen e ekuivalencës me standardet evropiane të mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe (iii) nisjen së punës për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), si pjesë integrale e axhendës së procesit të Berlinit.

Funksionimi i sistemit financiar është mbështetur nga një infrastrukturë efiçente e pagesave. Zhvillimet rregullatore dhe infrastrukturale në fushën e sistemeve të pagesave kanë sjellë zgjerimin e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave (me 25.5% në 2023). Shtimi i institucioneve të parasë elektronike ka nxitur përdorimin e këtyre instrumenteve, ndërsa përmirësimet në infrastrukturë kanë ulur kostot për kryerjen e pagesave. Zhvillimet e pagesave elektronike kanë kontribuar në përmbushjen e objektivave sasiorë të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), duke rritur nivelin e pagesave elektronike për frymë dhe përfshirjen financiare popullsisë.

Politikat ekonomike mbështetëse

Politika monetare vijoi kursin normalizues gjatë vitit 2023, duke synuar kthimin e inflacionit në objektivin 3%, në një kohë sa më të shpejtë dhe me kosto sa më të ulët mbi aktivitetin ekonomik. Ky normalizim u realizua nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit dhe vijimit të orientimit të tregut mbi kahun e pritshëm të saj në të ardhmen. Paralelisht me të, komunikimi mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen ruajti tiparet e një viti më parë, duke e kushtëzuar shpejtësinë dhe shkallën e normalizimit me informacionin e ri dhe me ecurinë e faktorëve me ndikim parësor në inflacion. Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ndihmoi në rënien e

inflacionit gjatë dy viteve të fundit, pa cënuar ó në të njëjtën kohë ó trendin pozitiv të rritjes ekonomike. Ai do të ndihmojë në stabilizimin e ekonomisë dhe në kthimin e inflacionit në objektiv gjatë vitit 2024.

Politika fiskale ka ndjekur një trajektore konsoliduese dhe natyre kundërciklike. Ajo është shprehur në rritje të të ardhurave, ulje të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Si politika monetare, ashtu dhe ajo fiskale kanë vepruar në të njëjtin kah dhe kanë mbështetur frenimin e akumulimit të presioneve inflacioniste dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë nuk ka caktuar masa të reja makroprudenciale apo ndryshuar masat ekzistuese. Vlerësimet dhe testimet e Bankës së Shqipërisë treguan se sistemi bankar ishte likuid dhe i mirëkapitalizuar për të përballuar skenarë të pafavorshëm makrofinanciarë.

Perspektiva ekonomike e vendit është pozitive. Rënia e inflacionit gjatë dy muajve të parë të vitit 2024 sinjalizon se ai po afrohet gjithnjë e më shumë në mënyrë të qëndrueshme drejt objektivit, moment të cilin parashikimet e Bankës së Shqipërisë e kanë treguar në mënyrë konsistente të ndodhë brenda vitit 2024. Konvergimi në objektiv do të mbështetet nga efektet e kursit normalizues të politikës monetare, nga stabilizimi i çmimeve në tregjet globale dhe nga zvogëlimi i presioneve të brendshme inflacioniste.

Aktiviteti ekonomik parashikohet të ngadalësohet disi gjatë vitit 2024, por të vijojë të shënojë ritme pozitive rritjeje. Rritja ekonomike do të përfitojë nga shëndeti i bilanceve të sektorit privat, nga ruajtja e një ambienti të qëndrueshëm bankar e financiar, nga vazhdimi i mbështetjes me kredi dhe nga vijimi i rritjes së të ardhurave nga eksporti. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik do të vijojë të pasqyrohet në rritje të mëtejshme pagash e punësimi çka do të ndihmojë në zgjerimin e të ardhurave të disponueshme të familjeve shqiptare.

4. VENDIMARRJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE EFEKTIVITETI

Këshilli Mbikëqyrës (KM) është organi më i lartë vendimmarrës i Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2023, Këshilli ka zhvilluar 15 mbledhjet e parashikuara në planin e punës. Këshilli miratoi 53 vendime, prej të cilëve, 39 ishin akte të reja dhe 14 ndryshime aktesh ekzistuese. Vendimet janë nxjerrë në përmbushje të detyrave ligjore të Këshillit, si: (i) stabiliteti monetar; (ii) licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; dhe (iii) ofrimi i infrastrukturës financiare (emisioni i kartëmonedhës dhe monedhës; tregu ndërbankar); dhe (iv) stabiliteti i sistemit financiar.

Vendimmarrja e politikës monetare ka konsistuar në krijimin e kushteve të përshtatshme monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kthimin e inflacionit në objektiv në periudhën afatmesme. KM ka vijuar me normalizimin e qëndrimit të politikës monetare. Njëkohësisht, ai ka rritur edhe normat e interesit për depozitën njëditore dhe kredinë njëditore, duke ruajtur një korridor simetrik rreth normës bazë. Rritja e normës bazë është përcjellë gradualisht në tregjet e brendshme financiare. Politika monetare vepron me kohëvonesa në ekonomi, por ato kanë patur ndikim pozitiv në kthimin në mënyrë të qëndrueshme të inflacionit pranë objektivit në afatin e mesëm.

Në spektrin e *ndryshimeve rregullatore mbikëqyrëse*, Këshilli ka marrë vendime për plotësimin dhe rishikimin e kuadrít rregullativ, nëpërmjet miratimit të akteve të reja dhe rishikimit të disa akteve në fuqi, duke e përafuar më tej këtë kuadër me acquis të BE-së. Ato lidhen me ndryshime në rregullore që lidhen me unifikimin e sistemeve raportuese si dhe me kërkesat për kapital, për rrezikun e kredisë dhe për rrezikun e tregut, si dhe për ekspozimet në titullzime.

KM miratoi në muajin maj Planin e Veprimit òPër administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025ò, i cili përcakton në mënyrë sistematike detyrat dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit, si: mbikëqyrja bankare, stabiliteti financiar, politika monetare, statistikat financiare dhe kërkimi shkencor. Vendime janë marrë dhe për dhënien e licencave për shërbime financiare institucioneve elektronike të parasë, duke shtuar gamën e shërbimeve financiare që i ofrohen qytetarëve, dhe duke mundësuar zgjerimin e veprimtarisë së institucioneve financiare jobanka në sistemin financiar.

Një sërë vendimesh të KM janë përqendruar në miratimin e rregulloreve për plotësimin e kuadrit rregullator për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave” të cilat përcaktojnë kërkesat për mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së institucioneve të pagesave si dhe ndryshime në rregullore për rishikimin e kërkesave raportuese për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike. Gjithashtu, masat e Bankës së Shqipërisë për uljen e kostove të pagesave ndërbankare dhe familjarizimi i popullsisë me teknologjitë e reja kanë nxitur rritjen e përfshirjes financiare. Përdorimi i instrumenteve elektronikë të pagesave ka njohur rritje gjatë vitit 2023.

Ndryshime rregullatore janë miratuar për hartimin dhe mbledhjen e statistikave, me qëllim përafrimin e tyre me kërkesat e Eurostat.

Gjatë vitit 2023, KM i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rreziqeve të sigurisë kibernetike për vijueshmërinë e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë dhe për funksionimin e sistemit bankar dhe financiar në vend. Këtë vit u hartua Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, dokumenti i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë. Në muajin nëntor, Këshilli miratoi strategjinë afatmesme dhe buxhetin orientues afatmesëm për vitet 2024-2026.

5. DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2023

Banka e Shqipërisë ka përbushur funksionet e saj, në zbatim të detyrimeve ligjore, të arritjes së objektivave strategjik afatmesëm, si dhe të respektimit të kërkesave të Kuvendit. Më poshtë, përmenden shkurtimisht disa nga drejtimit kryesore të punës së Banka e Shqipërisë, krahas atyre të raportuara në raportet periodike.

Në fushën e hartimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka rritur më tej kapacitet analizuese, parashikuese dhe kërkimore. Procesi i kryerjes së parashikimeve makroekonomike është përmirësuar nëpërmjet përditësimit të modeleve të parashikimit dhe plotësimit të skenarit bazë me skenarë alternativë dhe rreziku, duke mundësuar vlerësimin e mundësive të reagimit të politikës monetare.

Në fushën e stabilitetit financiar është punuar për plotësimin e kuadrit rregullativ dhe metodologjik makroprudencial. Baza rregullatore është plotësuar me rregulloren mbi treguesit që mbështesin zbatimin e masave makroprudenciale me objekt kredimarrësin, ndërsa bashkësia e dokumenteve metodologjike është plotësuar me një variant më të plotë dhe të përmirësuar të metodologjisë së ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit. Në funksion të implementimit të Strategjisë së Gjellbër Afatmesme 2023-2025 për "Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të Lidhura me Klimën në Sektorin Financiar" puna u përqendrua në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve analitike për vlerësimin dhe identifikimin e rreziqeve të klimës. Ato synojnë ndërtimin e një ushtrimi të posaçëm të provës së rezistencës së sektorit bankar ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe vlerësimin e kostove të mundshme të lidhura me zbatimin e një agjende të gjellbër në aktivitetin e sektorit bankar.

Në fushën e mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë vijoi progresin në drejtim të plotësimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të mbikëqyrjes bankare, me synim përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së dhe dokumentet e Bazel; të kuadrit rregullator në zbatim të ligjit òPër Shërbimet e Pagesaveò; si dhe të kuadrit të hartimit të statistikave financiare. Për shkak të zhvillimeve gjeopolitike në rrafsh global dhe pozicionimit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë aktive ndaj këtyre zhvillimeve, vëmendje të veçantë ka marrë rritja e masave parandaluese ndaj rrezikut kibernetik.

Shqipëria u hoq nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, ose òlista griò, nga FATF në muajin tetor të vitit 2023. Ky vlerësim i rëndësishëm erdhi si rrjedhojë e angazhimit dhe e reformave të ndërmarra për përbushjen e kriterëve të nevojshme nga institucionet në Shqipëri përfshi edhe Bankën e Shqipërisë. Me heqjen e Shqipërisë nga lista gri e FATF-së është hapur rruga për rikthimin formal në diskutimin me Autoritetin Bankar Evropian (EBA) mbi procesin e vlerësimit të ekuivalencës. Vlerësimet paraprake të pavarura të kuadrit mbikëqyrës aktual për bankat treguan se kuadri rregullativ e procedural, si dhe praktikat mbikëqyrëse, qëndrojnë në një nivel të lartë ekuivalence me standardet në vendet e Bashkimit Evropian.

Sistemi financiar është monitoruar nëpërmjet inspektimeve në vend, vlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve individuale dhe kontrollit për administrimin e tyre, si edhe në drejtim të licencimit të subjekteve. Gjatë vitit 2023, janë kryer në total 8 ekzaminime të plota në vend. Krahas rrezikut të kredisë, në fokus kanë qenë vlerësimi i kërkesave për kapital, i sistemeve dhe i kulturës së qeverisjes, i administrimit të rreziqeve, i teknologjisë së informacionit dhe i rrezikut të likuiditetit. Rekomandimet kryesore të lëna lidhen me nevojën për përmirësime në kulturën e qeverisjes së mirë, sigurimin efektiv të pavarësisë së kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive nga organet e larta drejtuese; për rritjen e investimeve në sistemet e mbrojtjes nga sulmet kibernetike dhe sigurimin e burimeve njerëzore të mjaftueshme; për përmirësime të kuadrit metodologjik për planifikimin dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme të kapitalit për mbështetjen e aktivitetit dhe për administrimin të rreziqeve financiare. Rekomandimet për subjektet jobanka lidhen me përmirësimin e saktësisë së raportimeve në Bankën e Shqipërisë, me rritjen e transparencën me klientët dhe me forcimin e kuadrit metodologjik për përmbushjen e kërkesave rregullatore e ligjore të lidhura me parandalimin e pastrimit të parave.

Në fushën e **ndërhyrjes së jashtëzakonshme**, janë përditësuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat e sektorit, si dhe janë komunikuar nivelet e kërkesës minimale për instrumente financiare, të tilla që bankat të kenë kapacitete financiare për të përthithur humbjet dhe për t'u rikapitalizuar përmes burimeve të brendshme, si dhe për të siguruar vijueshmërinë e funksioneve kritike. Gjithashtu, janë kryer inspektime në vend për të vlerësuar kapacitetet e tyre në rast të zbatimit të planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Në rolin e mbikëqyrësit dhe reformatorit të **sistemeve të pagesave**, Banka e Shqipërisë siguroi funksionimin normal të sistemeve të pagesave, nëpërmjet operimit dhe administrimit të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe 1 infrastrukturë për shlyerjen e titujve. Të gjitha sistemet kanë ofruar disponueshmëri maksimale. Në vitin 2023 nisi puna për anëtarësim e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), pjesë integrale e axhendës së procesit të Berlinit. Ky anëtarësim mundëson zbatimin e parimit të tarifave të barabarta si për pagesat kombëtare, ashtu edhe për ato ndërkufitare të përpunuara në mënyrë elektronike në euro.

Në përmbushje të funksionit të saj si **emetuese e parasë** shqiptare, Banka e Shqipërisë ka akomoduar kërkesën për *cash* në ekonomi. Në vitin 2023, përfundoi prezantimi i plotë i hedhjes në qarkullim të dy prerjeve të fundit të serisë së re. Ato kanë rezultuar të suksesshme në plotësimin e kërkesave të ekonomisë shqiptare në vlerë edhe në strukturë.

Administrimi i rezervës valutore kryhet në përputhje me politikën e administrimit, ku objektiv parësor është parimi i likuiditetit dhe ai i sigurisë. Gjatë vitit 2023, rezerva valutore është rritur me 890 milionë euro, duke regjistruar vlerën 5.846 miliardë euro në fund të vitit. Kthimi nga administrimi i rezervës ka rezultuar pozitiv, si pasojë e rritjes së normave të interesit në tregun ndërkombëtar gjatë vitit 2023.

Në drejtim të prodhimit dhe transmetimit të **statistikave**, Banka e Shqipërisë ka shënuar arritje në harmonizimin e statistikave me *acquis communitare*, ku veçohet përshtatja e kuadrit rregullator për raportimin e bilancit të gjendjes së fondeve të pensionit, të institucioneve të tjera financiare dhe të shoqërive të sigurimit dhe detajimi i të dhënave të transmetuara në Eurostat për statistikën e investimeve të huaja direkte dhe llogarive financiare.

Pjesë e punës së Bankës së Shqipërisë është edhe aktiviteti **kërkimor** në mbështetje të vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës. Fokusi i hulumtimit shkencor ishte analiza e fenomeneve ekonomike e financiare në funksion të politikës monetare e të stabilitetit financiar si dhe financa e gjelbër dhe sfidat e sistemit bankar në përballimin e rreziqeve të papritura natyrore.

Në fushën e **edukimit financiar**, këtë vit u hartua Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, dokumenti i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë. Disa nga objektivat kryesore të kësaj strategjie janë miradministrimi i financave personale dhe huamarrja e shëndetshme, planifikimi dhe kursimi për të ardhmen dhe mbrojtja e konsumatorit.

Nëpërmjet Departamentit të Kontrollit, puna për forcimin e **administrimit financiar dhe operacional** është përqendruar në administrimin e rrezikut operacional dhe në përforsimin e bazës rregullatore për ÷Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë për të përmirësuar aftësinë reaguese të Bankës kundrejt sulmeve kibernetike

6. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Banka e Shqipërisë ka përbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raport Progreset e Komisionit Evropian, nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo drejton kapitullin 4 ÷Lëvizja e lirë e kapitalit dhe kapitullin 17 ÷Politika ekonomike dhe monetare, dhe është kontribuuese në disa kapituj të tjerë të *acquis*.

Me hapjen e negociatave, ekupe të Banka e Shqipërisë kanë marrë pjesë dhe kontribuar aktivisht në takimet bilaterale screening për çdo kapitull të *acquis*-it midis delegacioneve shqiptare dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian. Në këto takime u parashtruan planet për përafrim të mëtejshëm me BE-në me anë të përbushjes së kriterëve në çdo kapitull negociues. Komisioni Evropian pritet të miratojë në Këshillin e BE-së një raport screening për secilin kapitull.

Në raport me përfaqësimet në institucione ndërkombëtare financiare, Banka e Shqipërisë ka përbushur detyrimet financiare dhe raportuese që rrjedhin nga anëtarësimi në FMN dhe BB.

7. PRIORITETET AFATMESME

Në muajin nëntor, Këshilli Mbikëqyrës miratoi Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2024-2026 e cila përditëson strategjinë ekzistuese, duke zgjatur afatin e zbatimit të saj përtej vitit 2025. Objektivat për periudhën afatmesme shërbejnë si bazë në procesin e buxhetimit, parashikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave për përbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji organik. Objektivat e Strategjisë përfshijnë edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Në përputhje me detyrat e përcaktuara në ligjin organik, prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë janë:

- **Forcimi i eficiencës dhe efektivitetit të politikës monetare dhe e cilësisë së vendimmarrjes**, përmes rritjes së saktësisë së parashikimeve e plotësimit të tyre me skenarë alternativë/rreziku, dhe vlerësimin të opsioneve të reagimit të politikës monetare e identifikimin e alternativave më eficiente.
- **Parandalimi i rreziqeve sistematike dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar**, duke u përqendruar në miratimin e metodologjisë për zbatimin e shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik, plotësimin e kuadrit rregullator mbi kërkesat për sektorin bankar për sigurimin e një mbrojtjeje të përshtatshme kibernetike, (hartimin e një metodologjie të ushtrimit të provës së rezistencës ndaj ndikimit të ndryshimit të klimës për sektorin bankar; përafrimin e Bazel 3 dhe hartimin e manualeve teknike për përgatitjen e planeve të kontingjencës, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
- **Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave** përmes përditësimit të sistemeve për akomodimin e zhvillimeve në fushën e pagesave me vlerë të vogël, mbështetjes së nismave ndërbankare për nxitjen e pagesave elektronike, pjesëmarrjes së aktorëve të rinj, pjesëmarrjes në Tregun Unik të Pagesave në EURO, dhe zhvillimit të projektit Instant Payment me Bankën e Italisë.
- **Ruajtja e besimit publik të kartëmonedha dhe monedha shqiptare** dhe plotësimi i nevojave në rritje të ekonomisë për para të gatshme e të përshtatshme për qarkullim.
- **Zbatimi i sistemit të ri për administrimin e portofolit të rezervës valutore**, në mbështetje të zbatimit të politikës monetare dhe shërbimeve të pagesave dhe të transfertave.
- **Harmonizimi i statistikave** financiare të qeverisë me kërkesat e BE-së dhe përmirësimi i aspekteve ligjore dhe cilësore për raportimin rregullator të të dhënave të mbikëqyrjes bankare.
- **Përditësimi i kuadrit të përgjithshëm kontabël, i infrastrukturës së rrjetit dhe i mbrojtjes kibernetike**, si dhe forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.